



## **BASHKIA E TIRANËS KËSHILLI BASHKIAK**

### **V E N D I M**

Nr. 61 datë 30.12.2015

**Për**

### **“MIRATIMIN E PËRDORIMIT TË OBJEKTIT KINEMA “AGIMI” PËR OFRIMIN E SHËRBIMEVE NË FUNKSION TË KOMUNITETIT DHE SHTRESAVE NË NEVOJË”**

Në mbështetje të nenit 7, pika 2, nenit 8, pika 1/II, shkronjat “a” dhe “c”, nenit 32, shkronja “e” dhe nenit 33, pika 4 të ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 për “Organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” (i ndryshuar); neneve 11 dhe 12 të ligjit nr. 8743, datë 22.02.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit” (i ndryshuar); nenit 1, pika 2, nenit 29, pikave 4 dhe 5 të ligjit nr. 9355, datë 10.03.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore” (i ndryshuar); vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 143, datë 18.01.2012 “Për miratimin e listës paraprake (pjesa e parë + pjesa e dytë) të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Tiranë, të qarkut të Tiranës”; vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore” (i ndryshuar); udhëzimit nr. 257, datë 28.04.2014 “Për zbatimin e vendimit të Këshillit të Ministrave nr.54 datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore””; kërkesës së Qendrës Kulturore “Tirana” për dhënie me qira të objektit Kinema “Agimi” dhe me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Tiranë, Këshilli Bashkiak,

### **V E N D O S I:**

1. Miratimin e përdorimit të objektit Kinema “Agimi” me sipërfaqeje totale prej 316.6 m<sup>2</sup>, sipas genplanit bashkëlidhur këtij vendimi, pjesë e inventarit të pronave të paluajtshme të Bashkisë së Tiranës, në administrim të Qendrës Kulturore “Tirana”, për ofrimin e shërbimeve komunitetit dhe shtresave në nevojë, në përputhje me funksionin që ka.
2. Miratimin e dhënies në parim me qira të tretëve, të objektit Kinema “Agimi” për një afat 5-vjeçar pa ndryshim destinacioni.
3. Ky proces të kryhet nëpërmjet procedurave të konkurimit në mbështetje të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore” (i ndryshuar).

4. Ngarkohet Kryetari i Bashkisë së Tiranës për lidhjen e kontratës së qirasë.
5. Për zbatimin e këtij vendimi, ngarkohet Qendra Kulturore “Tirana” dhe Drejtoria e Përgjithshme Juridike e Aseteve dhe Licensimit.
6. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**K R Y E T A R**

**ALDRIN DALIPI**